



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.391/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj - kryesuese, Bujar Muzaqi dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për asamble komunale në Komunën e Klinës, nga radhët e subjektit politik Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës (PSHDK), Tush Berisha, e paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me numër 01/3093-2025 të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.11.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZL.Anr.391/2025, e datës 04.11.2025, e parashtuar nga Tush Berisha, kandidat për asamble komunale në Komunën e Klinës, nga radhët e subjektit politik Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës (PSHDK), e paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me numër 01/3093-2025 të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 04.11.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidatit për asamble komunale në Komunën e Klinës, nga radhët e subjektit politik PSHDK, Tush Berisha, me të cilën ka paraqitur ankesë lidhur me rezultatet përfundimtare nga KQZ me ndarjen e mandateve në Komunën e Klinës. PSHDK pretendon se duke u bazuar në atë se ka marrë 293 vota apo 1.65% të votës së përgjithshme, si dhe në bazë të rezultateve analoge të Komunave tjera. Ankesës ia ka bashkangjitur dhe ankesën e bartëses së listës së PSHDK-së Anduena Culaj dhe krahasimin e mandateve me komunat e tjera.

Në përgjigjen në ankesë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datë 05.11.2025, ka deklaruar se pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me kërkesën e juaj jep sqarimet/ përgjigjet si më poshtë: Sipas dispozitave ligjore, përkatësisht nenit 8, paragrafit 4, në ndërlidhje me paragrafin 3, të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, përcaktohet qartazi që kuota gjinore prej 30% zbatohet brenda listave të subjekteve politike që kanë fituar mandate, me përjashtim të listave në kuadër të së cilave janë fituar dy mandate (ku ndarja bëhet në proporcion 50-50%) apo një mandat i vetëm (ku vendi i ndahet kandidatit apo kandidates më të votuar). Të vepruarit ndryshe, sipas kërkesës së palës ankuese, do të cenonte parimin e barazisë para ligjit, në atë mënyrë që po që se kuota për institucionin në tërësi do të përmbushej vetëm nga një apo më shumë subjekte politike, të tjerat do të

përfashtoheshin nga obligimi për të pasur të paktën 30% nga kandidatët e gjinisë së nën përfaqësuar që fitojnë vende në kuvendet komunale. Po ashtu legjislacioni zgjedhor në zgjedhjet lokale nuk përcakton kuotë për kuvendin komunal si tërësi, por për listat e subjekteve, si vijon:

Në kuptim të nenit 8 paragrafi 3 i Ligjit për Zgjedhjet Lokale, vendet që i ndahen subjektit politik sipas paragrafit 1 të këtij neni, u ndahen kandidatëve që gjenden në listën e rirenditur sipas paragrafit 2 të këtij neni, duke filluar nga kandidati i parë në listën e rirenditur sipas një renditje rreptësisht zbritëse, deri në mbarimin e vendeve që i ndahen subjektit politik,

"Neni 8.4 i Ligjit për Zgjedhjet Lokale, nëse pas ndarjes së vendeve, të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga një kandidat i përshtatshëm i gjinisë tjetër në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%".

Një përcaktim i tillë është rikonfirmuar edhe nga Gjykata Kushtetuese, përmes Aktgjykimit në rastet rastet K145/20 dhe K146/20, e cila mes tjerash përcakton:

"131. [...] Rrjedhimisht, parimet kushtetuese të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit mbeten të një rëndësie vendimtare dhe se çështja e kuotave gjinore, për arsye historike dhe kulturore, si dhe të mënjanimin të pabarazive faktike në mes grave dhe burrave, është në pajtueshmëri me frymën e sistemit normativ kushtetues."

"164 .., Gjykata potencoi se, ratio legis i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, në kontekst të përfaqësimit gjinor në Kuvend, konsiston në atë që siguron - në çdo rrethanë -përfaqësim prej të paktën 30% të gjinisë së nën përfaqësuar ose gjinisë pakicë (cilado qoftë ajo). Mirëpo, qartazi, 30% paraqet vetëm kufirin minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, por jo edhe kufirin më të lartë të përfaqësimit të njëres gjini. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se, në momentin që sigurohet përfaqësimi minimal prej 30% për gjininë e nënpërfaqësuar, të gjitha zëvendësimet e ardhshme duhet të bëhen në bazë të renditjes të kandidatëve për deputetë, të cilën e përcakton rezultati zgjedhor. Mbi këtë bazë, kuota gjinore zbatohet vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin është vendosur, pra, për të siguruar përfaqësimin e detyrueshëm minimal të gjinisë pakicë në kuotën prej 30%."

Në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, lidhur me formulën për ndarjen e ulëseve të Kuvendit të Komunës, si dhe numri më i vogël i kandidatëve nga gjinia e kundërt nëse numri i kandidatëve që kanë fituar mandatë është dy (2) atëherë numri më i vogël nga të dy gjinitë duhet të jetë një (1), pra duhet të jenë një mashkull dhe një femër.

Gjithashtu, edhe tek rastet kur subjekti politik ka fituar katër (4) ulëse, atëherë numri më i vogël nga të dy gjinitë duhet të jetë 2 (dy), pra duhet të jenë dy meshkuj dhe dy femra, sepse po që se do të jetë ndryshe atëherë nuk do të arrihet përfaqësimi minimal në kuotën prej 30%" i gjinisë së kundërt.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se:

- Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjeve në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se pretendimet e ankuesit Tush Berisha, janë të pa pabazuar sepse mos respektimi i kuotës nënkupton përfaqësim minimum 30% të gjinisë së kundërt dhe po që se përfaqësimi

është 50% nga kjo rezulton se nuk është në kundërshtim me ligjin, duke u bazuar në nenin 28.1 të LZP ku përcaktohet se: *“Në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku tridhjetë (30 %) për qind janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30 %) për qind janë femra; me nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku njëhere në secilin grup prej tre kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë”*.

Andaj duke i marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerësoi se pretendimet e parashtruesit të ankesës janë të pabazuara, i njëjti nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.391/2025, datë 05.11.2025

Kryesuese e Panelit
Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

AA.nr.110/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi, kryetar, Nenad Laziq dhe Delushe Halimi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Tush Berisha, kryetar i subjektit politik: Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës (PSHDK), dhe Anduena Culaj, candidate dhe bartëse e listës, nga radhët e këtij subjekti, të parashtruar kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.391/2025, të datës 05.11.2025, për shkak të rezultateve të shpallura për Zgjedhjet Lokale për Kuvendet Komunale në Republikën e Kosovës, të mbajtura më datë 12 tetor 2025, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 11.11.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pathemeltë ankesa e parashtruar nga ankuesit: Tush Berisha, kryetar i subjektit politik: Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës (PSHDK), dhe Anduena Culaj, candidate dhe bartëse e listës, nga radhët e këtij subjekti politik, kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.391/2025, të datës 05.11.2025.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.391/2025, të datës 05.11.2025, është vendosur: Refuzohet e pabazuar ankesa ZL.Anr.391/2025, e datës 04.11.2025, e parashtruar nga Tush Berisha, kandidat për asamble komunale në Komunën e Klinës, nga radhët e subjektit politik Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës (PSHDK), e paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me numër 01/3093-2025 të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.



Kundër këtij vendimi ankesë në Gjykatën Supreme, ka parashtruar kryetari i Partisë Shqiptare Demokristiane e Kosovës (PSHDK), dhe Anduena Culaj, kandidate dhe bartëse e listës, nga radhët e këtij subjekti, me të cilën e kontestojnë ligjshmërinë e tij, duke mos specifikuar në mënyrë të qartë bazat e atakimit të tij, duke propozuar nga Gjykata Supreme e Kosovës që të: prish vendimin e PZAP-it, ZL.Anr.391/2025, të datës 05.11.2025, ashtu që rishpërndarja e mandateve për Asamblenë Komunale në Komunën e Klinës, të bëhet në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur kundër vendimit të atakuar, i konteston në tërësi thëniet ankimore dhe propozon që ankesa e parashtruar nga kandidati për asamble komunale në Komunën e Klinës, Tush Berisha, ku janë përfshirë edhe pretendimet ankimore të kandidates Anduena Culaj, të refuzohet si e pabazuar, ndërsa vendimi i kontestuar i PZAP-it, ZL.Anr.391/2025, të datës 05.11.2025, të vërtetohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datën 04.11.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidatit për asamble komunale në Komunën e Klinës, nga radhët e subjektit politik PSHDK, Tush Berisha, me të cilën ka paraqitur ankesë lidhur me rezultatet përfundimtare nga KQZ me ndarjen e mandateve në Komunën e Klinës. PSHDK pretendon se duhet të jetë bazuar në atë se ka marrë 293 vota apo 1.65% të votës së përgjithshme, si dhe në bazë të rezultateve analoge të komunave të tjera. Ankesës ia ka bashkëngjitur edhe ankesën e bartëses së listës së PSHDK-së, Anduena Culaj, dhe krahasimin e mandateve me komunat e tjera.

Në përgjigjen në ankesë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datë 05.11.2025, ka theksuar se: Sipas dispozitave ligjore, përkatësisht nenit 8, paragrafit 4, në ndërlidhje me paragrafin 3, të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, përcaktohet qartazi që kuota gjinore prej 30% zbatohet brenda listave të subjekteve politike që kanë fituar mandate, me përjashtim të listave në kuadër të së cilave janë fituar dy mandate (ku ndarja bëhet në proporcion 50-50%) apo një mandat i vetëm (ku vendi i ndahet kandidatit apo kandidates më të votuar). Të vepruarit ndryshe, sipas kërkesës së palës ankuese, do të cenonte parimin e barazisë para ligjit, në atë mënyrë që po që se kuota për institucionin në tërësi do të përmbushej vetëm nga një apo më



shumë subjekte politike, të tjerat do të përjashtoheshin nga obligimi për të pasur të paktën 30% nga kandidatët e gjinisë së nën përfaqësuar që fitojnë vende në kuvendet komunale.

Po ashtu, legjislacioni zgjedhor në zgjedhjet lokale nuk përcakton kuotë për kuvendin komunal si tërësi, por për listat e subjekteve, si vijon: Në kuptim të nenit 8, paragrafi 3, i Ligjit për Zgjedhjet Lokale, vendet që i ndahen subjektit politik sipas paragrafit 1 të këtij neni, u ndahen kandidatëve që gjenden në listën e rirenditur sipas paragrafit 2 të këtij neni, duke filluar nga kandidati i parë në listën e rirenditur sipas një renditjeje rreptësisht zbritëse, deri në mbarimin e vendeve që i ndahen subjektit politik. Neni 8.4 i Ligjit për Zgjedhjet Lokale: *“Nëse pas ndarjes së vendeve të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga një kandidat i përshtatshëm i gjinisë tjetër në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%.”*

Një përcaktim i tillë është rikonfirmuar edhe nga Gjykata Kushtetuese, përmes Aktgjykimit në rastet K145/20 dhe K146/20, e cila, ndër të tjera, përcakton: *“131. Rrjedhimisht, parimet kushtetuese të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit mbeten të një rëndësie vendimtare dhe se çështja e kuotave gjinore, për arsye historike dhe kulturore, si dhe të mënjanimit të pabarazive faktike në mes grave dhe burrave, është në pajtueshmëri me frymën e sistemit normativ kushtetues.”*, dhe *“164. Gjykata potencoi se, ratio legis i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, në kontekst të përfaqësimit gjinor në Kuvend, konsiston në atë që siguron – në çdo rrethanë - përfaqësim prej të paktën 30% të gjinisë së nënpërfaqësuar ose gjinisë pakicë (cilado qoftë ajo). Mirëpo, qartazi, 30% paraqet vetëm kufirin minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, por jo edhe kufirin më të lartë të përfaqësimit të njëjës gjini. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se në momentin që sigurohet përfaqësimi minimal prej 30% për gjininë e nënpërfaqësuar, të gjitha zëvendësimet e ardhshme duhet të bëhen në bazë të renditjes së kandidatëve për deputetë, të cilën e përcakton rezultati zgjedhor. Mbi këtë bazë, kuota gjinore zbatohet vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin është vendosur, pra, për të siguruar përfaqësimin e detyrueshëm minimal të gjinisë pakicë në kuotën prej 30%.”*

Në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, lidhur me formulën për ndarjen e ulëseve të Kuvendit të Komunës, si dhe numrin më të vogël të kandidatëve nga gjinia e kundërt, nëse numri i kandidatëve që kanë fituar mandate është dy (2), atëherë numri më i vogël nga të dy



gjinitë duhet të jetë një (1), pra duhet të jenë një mashkull dhe një femër. Gjithashtu, edhe tek rastet kur subjekti politik ka fituar katër (4) ulëse, atëherë numri më i vogël nga të dy gjinitë duhet të jetë dy (2), pra duhet të jenë dy meshkuj dhe dy femra, sepse po që se do të jetë ndryshe, atëherë nuk do të arrihet përfaqësimi minimal në kuotën prej 30% të gjinisë së kundërt.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, me vendimin ZL.Anr.391/2025, të datës 05.11.2025, ka refuzuar të pabazuar ankesën e parashtruar nga Tush Berisha, kandidatit për asamble komunale në Komunën e Klinës, nga radhët e subjektit politik PSHDK.

PZAP, në arsyetim të vendimit të tij ndër të tjera ka theksuar se: Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjeve në ankesë të paraqitura nga KQZ-ja, vlerësoi se pretendimet e ankuesit Tush Berisha janë të pabazuara, sepse mosrespektimi i kuotës nënkupton përfaqësim minimal 30% të gjinisë së kundërt dhe po që se përfaqësimi është 50%, nga kjo rezulton se nuk është në kundërshtim me ligjin, duke u bazuar në nenin 28.1 të LZP-së, ku përcaktohet se: *“Në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku tridhjetë (30%) për qind janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30%) për qind janë femra; me nga një kandidat të secilës gjini, përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej tre kandidatësh, e që numërohet nga kandidati i parë në listë.”* Andaj, duke i marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerësoi se pretendimet e parashtruesit të ankesës janë të pabazuara, i njëjti nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse.”* Nga arsyet e theksuara më lart dhe duke u bazuar në nenin 117, paragrafi 3, lidhur me nenin 118, paragrafi 1, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, me të cilin e ka refuzuar të pabazuar ankesën e ankuesit Tush Berisha, për shkak të shpalljes së rezultateve përfundimtare, për Zgjedhjet Lokale për Kuvendet Komunale, që janë mbajtur më datë 12 Tetor 2025. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 03/L-072 Për Zgjedhjet Lokale në Republikën e



Kosovës, si dhe të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të cilat mutatis mutandis vlejné edhe për zgjedhjet lokale përveç nëse përcaktohet ndryshe me anë të këtij ligji.

Objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme të Kosovës ishin thëniet e parashtresve të ankesës përkitazi me ndarjen e mandateve për asamble komunale në Komunën e Klinës, ku ndër të tjera theksi i pretendimeve ankimore të ankuesve vihet në: pretendimin se ankueses Anduena Culaj, si bartëse e listës së Partisë Shqiptare Demokristiane (PSHDK), i është bërë padrejtësi në ndarjen e mandateve për Asamblenë Komunale të Klinës, pasi nuk i është dhënë mandati si asambleiste, pavarësisht se ka marrë një numër votash që sipas saj e justifikon këtë; nga rezultate analoge nga komunat tjera, kandidatë me përqindje të ngjashme të votave kanë marrë mandate dhe janë bërë pjesë e asambleve, duke argumentuar se nuk është ndjekur i njëjti kriter në rastin e saj; PZAP nuk ka dhënë verdikt mbi të drejtën e saj për mandat, por ka analizuar vetëm situata hipotetike, duke mos respektuar përfaqësimin politik të subjektit të saj; si dhe kundërshton gjithashtu interpretimin e kuotave gjinore si kriter për përfaqësimin politik, duke kërkuar që vendimi të bazohen në ligj dhe në kriteret e njëjta që janë përdorur në komunat tjera.

Gjykata Supreme e Kosovës, pretendimet e lartcekura i shqyrtoj në tërësi në baza ligjore dhe i refuzoj në tërësi si të pathemelta, sepse të njëjtat nuk janë provuar dhe faktuar, si dhe nuk kanë mbështetje ligjore, andaj, si të tilla juridikisht janë të paqëndrueshme. Gjykata vlerëson se vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.391/2025, të datës 05.11.2025, është nxjerrë në përputhje me dispozitat ligjore nga neni 8 [Shpërndarja e vendeve në Kuvendin e Komunës], paragrafët 3 dhe 4 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, ku përcaktohet se:

Paragrafi 3: “Vendet që i ndahen subjektit politik sipas paragrafit 1 të këtij neni, u ndahen kandidatëve që gjenden në listën e rirenditur sipas paragrafit 2 të këtij neni, duke filluar nga kandidati i parë në listën e rirenditur sipas një renditje rreptësishtë zbritëse, deri në mbarimin e vendeve që i ndahen subjektit politik.”.

Ndërsa sipas paragrafit 4: “Nëse pas ndarjes së vendeve, të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga një



kandidat i përshtatshëm i gjinisë tjetër në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%.”,

Duke pasur parasysh dispozitat e lartcekura, kolegji i kësaj gjykate vlerësoj se PZAP, ka shqyrtuar të gjitha pretendimet e palës ankuese, duke konstatuar njëherit se ankuesi nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse që të tregojnë se ka pasur padrejtësi në ndarjen e mandateve. Ky vendim me të drejtë është bazuar mbi përfaqësimin minimal të gjinisë, ngase një vendim ndryshe do të cenonte parimin e barazisë para ligjit në atë mënyrë që po që se kuota për institucionin në tërësi do të përmbushej vetëm nga një apo më shumë subjekte politike, të tjerat do të përjashtoheshin nga obligimi për të pasur të paktën 30 % nga kandidatët e gjinisë së nën përfaqësuar që fitojnë vende në kuvendet komunale.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se nr. Ligji nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nuk garanton ndarje të mandateve në mënyrë identike me komunat e tjera të cilat janë marrë si shembuj nga ankuesja. Për më tepër në asnjë dispozitë ligjore të këtij ligji nuk përcaktohet kuotë për kuvendin komunal si tërësi por për listat e subjekteve, andaj edhe ndarja e ulëseve varet ekskluzivisht nga rezultati i votave brenda asaj komune dhe renditja e kandidatëve në listën e subjektit politik, duke respektuar kuotën minimale gjinore prej 30%. Çdo komunë ka numër të ndryshëm votash dhe rezultate zgjedhore, ndërsa ligji përcakton renditjen e mandateve sipas listës së riorganizuar dhe kuotave gjinore, jo sipas krahasimeve me komunat e tjera.

Për më tepër, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, në rastet K145/20 dhe K146/20, konfirmon se kuota gjinore prej 30% përfaqëson nivelin minimal të detyrueshëm të përfaqësimit të gjinisë së nënpërfaqësuar. Çdo zëvendësim tjetër i kandidatëve duhet të bëhet duke ndjekur renditjen e listës dhe rezultatet zgjedhore. Për këtë arsye, kur një subjekt politik fiton një, dy, katër ose më shumë ulëse, është e detyrueshme që të respektohet përfaqësimi minimal i gjinive sipas ligjit.

Mbi barrën e provës dhe standardin ligjor: Sipas nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme: *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse, dhe barra e provës bie mbi palën ankuese.”* Në këtë rast, ankuesit, nuk kanë paraqitur dëshmi të tilla, përkundër asaj që kërkohet me ligj. Prandaj, edhe PZAP me të drejtë ka vlerësuar se pretendimet e tyre nuk mbështeten në prova faktike apo juridike, dhe ka refuzuar ankesën.



Gjykata vlerëson se PZAP ka vepruar në përputhje me ligjin dhe ka vlerësuar drejt faktet dhe provat në dosjen përkatëse. Gjykata nuk gjen prova të mjaftueshme për të konkluduar se ndarja e ulëseve për asamblenë komunale nuk është e drejtë dhe e ligjshme, siç pretendon pala ankuese.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragraf 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.110/2025 më datë 11 nëntor 2025

Kryetar i kolegjit,

Faton Ademi



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtor i autorizuar
Ovlašćeni radnik



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL

PZAP

DOSTAVNICA ZA LJICNO DOSTAVLANJE
PRISHTINE

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

AA-110/2025

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dëshitë të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së lajmerimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërsës, fqijt, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena: odraslom članu domaćin, Primaoca nastojniku zgrade susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribieno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____
dana _____ u _____ cas.

Shkaku i refuzimit të marrjes
Razlog odbijanja prijmea

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaoca

(Të panevojshmeve bjeri vizë - nepotrebuje precrati)

Në rast se marrësi është analabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesit, duke shkruar shkaku pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ako je primilac neptismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljaoc. napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.

Em 12/08

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

AKT624KIM
11.11.2025

Numri i shtojcave:
broj priloga

2

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur
më (me fjalë)

Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima)

11.11.2025

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primaoca ili lica koje je
pismeno primilo u zameni)

VSH . 11.03

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaoca